




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Njoftim publik



Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit – Komuna e Prishtinës, ka filluar procedurën me numër _____ përmes së cilës kërkohet nga banorët të cilët dalin në këtë që të emërtohet rruga e cilat gjendet në Zonën Kadastrale Bërnice e Epërme.

Agjencia Kadastrale e Kosovës e ka digjitalizuar (si rrugë të re) segmentin e rrugës që shtrihet në këtë hapësirë, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në kërkesën e banorëve si dhe Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 5, Neni 6, pika 1.1.16., Neni 7, pika 1, pika 2, pika 3., 3.1., dhe pika 3.3., të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPHI – së, i ka dhënë kësaj rruge të re një kod të veçantë (kodi 10877) dhe ka bërë propozimin për emërtim e kësaj rruge.

Emrat e propozuar:

- GANI ZOGAJ (1973- 1998) Dëshmor,
- FEIM AJETI (1983 - 1999) Dëshmor,
- HABIB SEJDIU (1964 - 1999) Dëshmor.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 01.08.2025 deri më 08.08.2025, në E-mail adresën: urbanizmpirishtine@rks-gov.net

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPHI –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtim, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.

10877

29.07.2025 13:48



Nënshkrimi i Zyrtarit:



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmpirishtine@rks-gov.net